



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2018

V E N D I M

Nr. 49, Datë 7 / 2 / 2018

Bazuar në informacionin me shkrim¹ të marrë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe shoqata “Together for Life”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: *“Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”*, nenin 41/2/a të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara”*, me Urdhrin nr. 27, datë 24.02.2017, filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me mungesën e ilaçeve gjatë muajit Janar 2017 në Shërbimin e Hematologjisë pranë QSUT²-s.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

KONSTATOI:

Sipas informacionit të dhënë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe shoqata “Together for Life”, shpjegojnë se: *“Në muajin Janar 2017 kanë trajtuar ankesat e pacientëve për mungesë të ilaçeve që janë pjesë e kimioterapisë për mjekimin e sëmundjeve në Shërbimin e Hematologjisë pranë QSUT-s. Sipas këtyre ankesave, për shkak të mungesës së ilaçeve, pacientët e planifikuar për mjekim pranë këtij pavijoni në muajin Janar 2017 kanë dalë nga spitali pa marrë mjekimin e planifikuar sipas terapisë mjekësore. Disa ilaçe që duhet të sigurohen nga shteti janë të papërbalueshme për shkak të kostos së lartë financiare, ndërsa ilaçe të tjera pacientët i sigurojnë me të ardhurat e tyre. Bashkëshorti i pacientes G.D ka informuar se për ciklin e fundit, bashkëshortja e tij është shtruar në shërbim në datë 23.01.2017 deri në datë 02.02.2017 dhe ka marrë vetëm një ilaç Velcade nga katër të tilla që përmban ciklin e kimioterapisë. Shkak i*

¹ Shkresa nr. 56, datë 04.02.2017

² Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

mungesës së mjekimit ka qenë mungesa e sasisë së ilaçit Velcade për mjekimin në përputhje me terapinë e caktuar nga mjeku. Në të njëjtën situatë ndodhen të gjithë pacientët që trajtohen në pavijonin e Hematologjisë pasi rezulton se sasia e ilaçeve të siguruara është e pamjaftueshme për të kryer mjekimet e plota gjatë shtrimit disa-ditor. Sipas pacientëve, në pavijonin e Hematologjisë në QSUT kanë munguar plotësisht apo pjesërisht këto ilaçe:

- Nga data 4-27 janar 2017 ka munguar ilaçi Mabthera;
- Nga data 5-23 janar 2017 ka munguar ilaçi Velcade;
- Në datat 19 dhe 23 janar 2017 ka munguar ilaçi Endoxan;
- Nga data 18-23 janar 2017 ka munguar ilaçi Nepogen;

Mungesat e ilaçeve të mësipërme rezultojnë në kartelat mjekësore të pacientëve që trajtohen në këtë pavijon, pasi mjekët përgjegjës për ndjekjen e terapisë si dhe zhvillimin e cikleve kanë bërë shënimet për mungesën e këtyre ilaçeve.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe shoqata “Together for Life” vlerësojnë se, praktika e mungesës së ilaçeve dhe mjekimit të mangët ndaj të gjithë pacientëve, dhe posaçërisht ndaj pacientes G.D i ka venë pacientët e sëmurë me kancer në gjak në kushte jo të favorshme për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore dhe gjendjes së vështirë ekonomike, në raport me personat e tjerë, si dhe cenon jetën e shëndetin e tyre”.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike dhe shëndetësore janë shkaqe të mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 217/1, datë 02.03.2017 është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT) në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim.

Me shkresën nr. 1181/5, datë 10.03.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, QSUT, në mes të tjerash informon se: *“Në tre vitet e fundit, bazuar në reformën e bërë nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me uljen e çmimeve dhe heqjen e TVSH së barnave, janë rritur ndjeshëm e në mënyrë progresive sasishtë e barnave bazuar në listën e barnave të miratuara nga MSH për përdorim në shërbimin spitalor universitar. Çdo vit QSUT organizon punën duke ngritur grupet e punës me përbërje të stafit mjekësor teknik, për të përcaktuar nevojat në lidhje me planifikimin me barna për shërbimet mjekësore. Sqarojmë se planifikimi i barnave dhe materialeve të mjekimit është një proces që kryhet nga ekipe mjekësore të Shërbimeve Mjekësore të QSUT dhe ai fillon gjatë muajve tetor-dhjetor mbi planifikimin e nevojave të shërbimeve klinike për barna bazuar në Projekt/Buxhetin e kërkuar. Në projekt-buxhetin e kërkuar çdo vit QSUT ka vlerësuar të paraqesë kërkesat e të gjithë shërbimeve mjekësore sipas vlerësimeve totale të realizuara nga ekipet mjekësore. Këto kërkesa përcillen në MSH për miratim. Pas miratimit të buxhetit vjetor për spitalet, grupi i punës rianalizon dhe dërgon për miratim nevojat për barna dhe materiale mjekësore bazuar në konsumet e viteve paraardhës, buxhetin e alokuar të 3 viteve të fundit bazuar në protokollet e mjekimit të miratuara nga MSH. Sa më sipër shërbimet mjekësore dhe stafi mjekësor i kryesuar nga Shefat e Shërbimeve si në rastin në fjalë Shërbimi i Hematologjisë, është pjesë përbërëse e përcaktimit të nevojave për barna bazuar në buxhetet e alokuara vjetore. QSUT ka marrë të gjitha masat për zbatimin e të gjitha procedurave në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore. Furnizimi i shërbimeve spitalore me barna dhe materiale mjekimi realizohet bazuar në buxhetin e miratuar nga MSH dhe kontratat e lidhura me operatorët ekonomikë, të cilët kanë përgjegjësi të furnizojnë spitalin me barna dhe materiale mjekësore bazuar në afatet e lëvrimit të përcaktuara. Vonesat për mospërbushje të kontratave saktësohen në legjislacionin për prokurimin publik. Problematikat në lidhje me vonesa sporadike në lidhje me importin e barnave specifike, kryesisht jo gjenerike apo mos ofertimin e operatorëve ekonomikë, të cilët zotërojnë regjistrim apo tregtohen me leje importi, referohen në çdo rast në MSH si institucioni epror. Informojmë së Shërbimi Hematologjisë, është shërbimi i cili përgjigjet për zbatimin e protokolleve të miratuara nga MSH, i cili përcakton skemat e mjekimit bazë si dhe skemat alternative bazuar në kriteret e përcaktuara dhe listën e pacientëve që marrin trajtim. Sa më sipër është përgjegjësi e Shërbimit respektiv dhe stafit mjekësor përcaktimi i skemave të mjekimit, koordinimi me strukturat përgjegjëse në funksion të trajtimit efikas të pacientëve”.*

- Me shkresën nr. 373, datë 19.04.2017 nga ana e Komisionerit i është kërkuar subjektit QSUT, informacion shtesë në lidhje me: - Me çfarë barnash janë trajtuar pacientët (në veçanti pacientja G.D) gjatë muajit Janar 2017, dhe si është siguruar ai? -Kopje të shkresave që janë dërguar në MSH në lidhje me problematikat dhe mospajtimin e ilaçeve për pacientët e pavijonit të Hematologjisë gjatë muajit Janar 2017 dhe përgjigjet e marra nga ministria. - Çfarë veprimesh të tjera ka bërë QSUT-ja për sigurimin e barnave në kohë? Nëse po, kopje të dokumentacionit.

Me shkresën nr. 1952/3, datë 08.05.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, QSUT, informon se: *“Nga Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik bëhet me dije se pas përfundimit të sasisë së prokuruar për vitin 2016, bazuar në legjislacionin në fuqi mbi prokurimin publik dhe në sasisë të prokuruar në vitin 2016, gjatë muajit janar janë lidhur shtesat e kontratave (20%). Për barin Velcade (Bortezomib 3.5mg) lidhja e shtesës së kontratës me operatorin ekonomik “R.F” është bërë nga Drejtoria Juridike në datë 13.01.2017 me nr. Prot. 290/2. Në vijim jemi furnizuar nga operatori “R.F” në datë 19.01.2017 dhe më pas Shërbimi i Hematologjisë ka bërë shpërndarjen e këtij bari respektivisht në datat: -23.01.2017 janë shpërndarë 10 flakonë, - 06.02.2017 janë shpërndarë 12 flakonë, - 16.02.2017 janë shpërndarë 13 flakonë, - 28.02.2017 janë shpërndarë 8 flakonët e fundit të kësaj kontrate. Në vijim, Shërbimi është furnizuar sipas kontratës së negociimit të lidhur me furnitor “I....” me nr.744/49, datë 23.02.2017 dhe aktualisht shpërndarja ka qenë e rregullt dhe periodike sipas grafikut të rënë dakort me Shërbimin përkatës”.*

Me shkresën nr. 15, datë 10.03.2017, Shërbimi i Hematologjisë, ka informuar Drejtorinë e QSUT se: *“Nga të dhënat e kartelës nr.A038906 të G.D e shtruar në Shërbimin e Hematologjisë datë 23.01.2017, figuron se ka marrë një dozë mjekimi me Valcade (Bortezomid). Sqarojmë gjithashtu se i takon Drejtorisë së Farmacisë QSUT të japë shpjegim për munges ose jo të medikamenteve të përmendura”.*

Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve e cila nuk u realizua në datë 28.12.2017 për arsye të mospjesëmarrjes së përfaqësuesve të QSUT-s.

Me shkresën nr.18, datë 12.01.2018, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka dërguar pranë Komisionerit, parashtrime shtesë lidhur me informacionet e dhëna nga QSUT-ja, në të cilën shpjegon se: *“Siç konstatohet, QSUT ka pohuar se, sigurimi i barnave bëhet mbi bazën e konsumit të viteve paraardhëse apo të buxhetit të alokuar në 3 vitet e fundit dhe jo mbi bazën e nevojave reale për mjekimin e pacientëve që trajtohen në Pavionin e Hamatologjisë, bazuar në gjendjen shëndetësore të tyre dhe në protokollin e mjekimit të sëmundjeve përkatëse. Mungesa e një apo disa ilaçeve, e plotë apo e pjesshme, gjatë kryerjes së cikleve mjekësore në këtë pavion është me pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e pacientëve aq më tepër kur ky shërbim në QSUT është*

unik dhe trajton pacientë nga zona të ndryshme të vendit..... Fakti i lidhjes së shitesës së Kontratës për ilaçin Velcade në datë 13.01.2017 tregon detyrimin ligjor që ka QSUT për sigurimin e ilaçeve por njëkohësisht edhe mungesën që ka patur Shërbimi i Hematologjisë për ilaçin në fjalë në muajin Janar 2017”.

Në analizë të legjislacionit dhe dokumenteve të shqyrtuara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 55/1 parashikon se: *“Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti”*. Gjithashtu në Kreun V, Objektivat Socialë, neni 59/1, germa “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm”*.

Referuar “Rregullores bazë të funksionimit të QSUT ‘Nënë Tereza’” pika 3.1, Drejtori i Përgjithshëm, Përshkrimi i Përgjithshëm i Pozicionit, përcaktohet se: “Drejtori i Përgjithshëm i QSUT është titullari më i lartë ekzekutiv, drejtues, organizues dhe kontrollues i të gjithë veprimtarisë së kësaj qendre”. Në pikën 3.11 të kësaj rregulloreje, Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik, Përshkrimi i Përgjithshëm i Pozicionit, përcaktohet se: “Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Farmaceutik është në varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe drejton e kontrollon punën e drejtorisë dhe ka për qëllim dhe objektiv të punës mirë-planifikimin vjetor bazuar mbi kërkesat e ardhura nga shërbimet e QSUT-së, historikut të konsumit, dhe në bazë të buxhetit të miratuar nga FSDKSh, dhe Drejtoria e QSUT-së, mirë-administrimin e barnave dhe materialeve mjeksore në përmbushje të nevojave të të gjithë shërbimeve të QSUT”, ndersa më poshtë tek, Përgjegjësitë kryesore, përcaktohet se: “Monitorimi i shpenzimit nga konsumi i barnave dhe materialeve mjekësore nëpër shërbimet/repartet e QSUT-së, duke vënë në dijeni menjëherë Drejtorinë për pikat kritike dhe duke bërë propozimet përkatëse”.

Bazuar në sa më sipër, provohet se është QSUT-ja që ka përgjegjësinë e sigurimit dhe mirëadministrimit të barnave për pacientët dhe mënyra se si i siguron ato në sasi dhe kohë është pjesë e procedurave nga ana e strukturave të QSUT-së dhe Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik është përgjegjëse për monitorimin e procedurave të konsumit të barnave dhe marrjen e masave në kohë për sigurimin e barnave që janë në mbarim e sipër, sidomos barnat objekt i shqyrtimit të ankesës që janë jetikë për shëndetin e pacientëve të sëmurë me kancer.

Referuar në sa më sipër nga ana e QSUT-s nuk u vendos në dispozicion të Komisioneri asnjë dokument që të provonte se nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Farmaceutik, si drejtori përgjegjëse për monitorimin e konsumit të barnave dhe të vënies në dijeni të menjëhershme të drejtorisë së spitalit, të ishte informuar në kohë apo të ishin bërë propozimet përkatëse për zgjidhjen në kohë të situatës së mungesës së barnave në Shërbimin e Hematologjisë.

Referuar shkresës nr.1952/3, datë 09.05.2017 të dërguar nga QSUT, në të cilën informohet se gjatë muajit Janar 2017, janë lidhur shtesat e kontratave për barin Velcade (Bortezomib 3.5 mg), Komisioneri vlerëson se, nisur nga kjo e dhënë, QSUT pranon faktin e mungesës së barit për periudhën e muajit Janar 2017 dhe për vetë rëndësinë që ka trajtimi i këtyre pacientëve me medikamentet e përcaktuara, drejtuesit e QSUT-s duhet ti kishin kushtuar vëmendjen maksimale sigurimit të barnave: Mabthera, Velcade, Endoxan dhe Nepogen pasi mungesa e këtyre barnave për pacientët që vuajnë nga sëmundja e mielome multiple mund të sjellë pasoja të parikuperueshme për jetën e shëndetin e tyre.

Mungesa e medikamenteve dhe mosofrimi i shërbimeve cilësore në shërbimin shëndetësor publik, bie ndesh me të drejtat e sanksionuara, në të drejtat dhe detyrimet e pacientit, në të cilën shpjegohet se: “Të gjithë pacientet kanë të drejtë të mjekohen. Ata kanë të drejtë për kujdesje për shëndetin e tyre; ta përfitojnë atë sipas nevojave, si në raste akute ashtu dhe në raste kronike, të shërbimit parësor dhe spitalor si edhe të kujdesit në bashkësi, pa marrë parasysh aftësinë e tyre për të paguar³”.

Në analizë të pretendimeve të subjektit ankues, sjellim në vëmendje, Nenin 82, pika 2, të Ligjit Nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, ku parashikohet: **“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”**. Në lidhje më sa më sipër, QSUT nuk vuri në dispozicion të Komisionerit, prova dhe të jepte argumente të arsyeshme dhe të ligjshme për sigurimin e barnave të tjerë si: MabThera, Endoxan dhe Neupogen si dhe të vërtetonte se ka informuar Ministrinë së Shëndetësisë, si institucion epror, në lidhje me problematikat dhe mospagimin e barnave për pacientët e shërbimit të Hematologjisë gjatë muajit Janar 2017.

Drejtoria e QSUT që nga periudha kur është informuar për mungesën e barnave të sipërcituar duhet të kishte marrë masat për sigurimin në kohë të barnave për pacienten G.D dhe për të gjithë pacientët e shërbimit të Hematologjisë në mënyrë që këtyre pacientëve tu bëhej e mundur marrja e mjekimit të plotë dhe efikas sipas përcaktimeve të përshkruara nga mjeku.

Në nenin 20, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” pika 1 dhe 2 përcaktohet ndalimi i diskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve, në të cilin shkruhet se: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime*

³ <http://www.qsut.gov.al/index.php/per-pacientet-dhe-familjaret/prishmeria-e-pacientit/te-drejtat-dhe-detyrimet-e-pacientit/>

i ofrohen publikut në përgjithësi” neni 2/b “Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: mundësi për të marrë ose për të përfutuar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Drejtoria e QSUT-s dhe në veçanti Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik, si njësi përgjegjëse për monitorimin e konsumit të barnave, duhet të kishte marrë masat në kohë për ti siguruar pacientes G.D dhe pacientëve të tjerë të shërbimit të Hematologjisë, medikamentet e duhura në kohën e duhur në mënyrë që të gjithë pacientët e shërbimit të Hematologjisë të marrin mjekimin e plotë sipas protokollit përkatës për të siguruar efektin maksimal të barit në kohën e duhur.

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, diskriminimi përkufizohet si: *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Sipas nenit 3/2, të po këtij ligji përcaktohet si diskriminimi i drejtpërdrejtë: *“ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga palët, vlerëson se veprimet e kryera nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, duke mos bërë të mundur sigurimin në kohë të medikamenteve mjekësore, përbëjnë diskriminim të drejtpërdrejtë të G.D dhe të gjithë pacientëve të shërbimit të Hematologjisë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1/2, 7/1, 20/1/2, 32/1/a dhe c/ dhe nenin 33/10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të G.D dhe të gjithë pacientëve të shërbimit të Hematologjisë, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e QSUT-s.
2. Në referim të pikës 1, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të sigurojë në kohë dhe në sasi, medikamentet mjekësore që nevojiten në Shërbimin e Hematologjisë, sipas parashikimeve ligjore.

3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: gjendja shendetesore)

(fusha: te mira dhe sherbime)